

KARTE KREDITI FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR

Zërat	Përshkrimi																						
Teksti prezantues	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.																						
1. Banka	BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A Adresa: Bulevardi “Rruga Vilave”, Lundër 1, Tiranë Adresa e web-it: www.bkt.com.al Email: info@bkt.com.al Numri i telefonit: 042 266 288																						
2. Emri i Produkti	Kartë Kredi																						
3. Lloji i Kredisë	Karta e Kreditit është një linjë kredie e përcaktuar si një limit karte që mund të përdoret nëpërmjet kartës plastike të branduar PRIMA. BKT përdor karta krediti Revolving. Kartë krediti Revolving konsiderohet karta që lëshohet me një linjë krediti qarkulluese me opsionin e shlyerjes së detyrimit minimal.																						
4. Vlera e kredisë dhe monedha e ofruar	<p>Shuma maksimale – deri në 3 të ardhura mujore Monedha e kredisë – Lek Limiti i kartës - përcaktohet në bazë të pikëve totale që klienti do të grumbullojë sipas sistemit të vlerësimit si më poshtë:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi i klientit</th> <th>Shuma maksimale e kredisë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>>=526</td> <td>1,000,000</td> </tr> <tr> <td>491-525</td> <td>800,000</td> </tr> <tr> <td>456-490</td> <td>600,000</td> </tr> <tr> <td>421-455</td> <td>500,000</td> </tr> <tr> <td>386-420</td> <td>400,000</td> </tr> <tr> <td>351-385</td> <td>300,000</td> </tr> <tr> <td>321-350</td> <td>200,000</td> </tr> <tr> <td>291-320</td> <td>100,000</td> </tr> <tr> <td>260-290</td> <td>50,000</td> </tr> <tr> <td><260</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për Klientë që ofrojnë garanci peng depozite/llogarie limitit i kartës nuk duhet të jetë më i lartë se 90.91% (nëse kolaterali ka të njëjtën monedhë me kartën e kreditit) ose 83.33% (nëse kolaterali ka monedhë të ndryshme nga karta e kreditit)</p>	Vlerësimi i klientit	Shuma maksimale e kredisë	>=526	1,000,000	491-525	800,000	456-490	600,000	421-455	500,000	386-420	400,000	351-385	300,000	321-350	200,000	291-320	100,000	260-290	50,000	<260	-
Vlerësimi i klientit	Shuma maksimale e kredisë																						
>=526	1,000,000																						
491-525	800,000																						
456-490	600,000																						
421-455	500,000																						
386-420	400,000																						
351-385	300,000																						
321-350	200,000																						
291-320	100,000																						
260-290	50,000																						
<260	-																						
5. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	Karta Prima ofrohet për një afat 72-mujor (6 vjet), e rinovueshme automatikisht për të njëjtin afat. Konsumatori ka të drejtë të përdorë të gjithë limitin e Kartës së Kreditit dhe të shlyejë brenda një muaji 25% të shumës së përdorur dhe çdo muaj në vijim 25% të detyrimit të mbetur/shtuar. Çdo shumë e paguar do të jetë përsëri e disponueshme për përdorim.																						
6. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)	Norma fikse e interesit për kredinë (ose detyrimin e mbartur) e shprehur në terma vjetore është 24% (2% mujore). Norma fikse e interesit për tërheqje e shprehur në terma vjetore është 30% (2.5% mujore). Norma fikse e interesit për blerje me këste e shprehur në terma vjetore është deri në 30% (2.5% mujore). Sipas ofertave dhe marrëveshjeve në fuqi të BKT me tregtarë partnerë, ofrohen edhe blerje me këste me 0% interes.																						
7. Norma efektive e interesit	NEI llogaritet duke u bazuar në normën nominale të interesit (interesi për detyrimin e mbartur mujor), limitin total të kartës, komisionin vjetor të kartës, duke marrë në konsideratë që ky komision është 0 për vitin e parë, si dhe komisionin e mirëmbajtjes së llogarisë. Gjatë përllogaritjes supozohet lëvrimi dhe përdorimi i menjëhershëm i limitit të kartës, pa qarkullime dhe përdorime të mëtejshme, pagesa mujore për detyrimin minimal dhe likuidimi i plotë për 2 vjet (24 muaj)*. NEI llogaritet sipas formulës:																						

	$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-k} = \sum_{p=1}^n P_p (1+i)^{-p}$ <p>ku m është numri i periudhave të qarkullimit të kredisë, k është numri në vazhdimësi i periudhave për kredinë qarkulluese ($1 \leq k \leq m$), K_k është vlera faktike e kredisë (cash flow) në dispozicion të konsumatorit për periudhën k, tk është intervali i shprehur në vite dhe fraksione të një viti ndërmjet datës së lëvrimit të kredisë dhe datës së çdo qarkullimi të kësaj kredie, n është numri i periudhave të pagesave nga konsumatori, p është numri në vazhdimësi i periudhave të pagesave për shlyerjen e kredisë, P_p është vlera e pagesës së shpenzimeve nga konsumatori për periudhën p, tp është intervali i shprehur në vite dhe fraksione të një viti ndërmjet datës së lëvrimit të kredisë dhe datës së çdo periudhe pagese dhe i është NEI.</p> <p><u>Shembull:</u></p> <table border="1" data-bbox="443 658 1374 882"> <thead> <tr> <th></th> <th>Prima</th> <th>Prima Gold</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Limiti total i kartës</td> <td>150,000 LEK</td> <td>150,000 LEK</td> </tr> <tr> <td>Komisioni vjetor (për vitin e 1-rë)</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Komisioni vjetor (për vitin e 2-të)</td> <td>1,500 LEK</td> <td>3,000 LEK</td> </tr> <tr> <td>NEI</td> <td>22.40%</td> <td>24.70%</td> </tr> </tbody> </table> <p>*NEI përllogaritet në vlera të përafërta edhe në kushtet e qarkullimit dhe përdorimit të mëtejshëm të limitit të kartës. Nëse do të konsiderojmë edhe ofertat për kthimin e komisionit vjetor në formë bonusi, NEI llogaritet në vlera akoma më të ulëta. Në kushtet që konsumatori paguan rregullisht detyrimin total, NEI zbret në vlera minimale ~ 1%.</p>		Prima	Prima Gold	Limiti total i kartës	150,000 LEK	150,000 LEK	Komisioni vjetor (për vitin e 1-rë)	0	0	Komisioni vjetor (për vitin e 2-të)	1,500 LEK	3,000 LEK	NEI	22.40%	24.70%
	Prima	Prima Gold														
Limiti total i kartës	150,000 LEK	150,000 LEK														
Komisioni vjetor (për vitin e 1-rë)	0	0														
Komisioni vjetor (për vitin e 2-të)	1,500 LEK	3,000 LEK														
NEI	22.40%	24.70%														
<p>8. Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme</p>	<p>Marrëveshje siguroese për kartë krediti me garanci peng depozite/ llogarie. (Vetëm në rastet kur limiti është i siguar me peng depozite/llogarie)</p>															
<p>9. Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve</p>	<p>Pas hapjes të limitit të aprovuar, fondet kalojnë në kartën Prima. Me marrjen në dorëzim dhe aktivizimin e kartës, konsumatori mund të kryejë transaksione (pagesa ose tërheqje) nëpërmjet kartës, deri në limitin e disponueshëm (100% e limitit të kartës për pagesa dhe 10% për tërheqje). Transaksionet në monedha të huaja do të konvertohen dhe faturohen në monedhën e pasqyrës mujore (statement) të konvertuara sipas kursit të MasterCard /Visa dhe Bankës.</p>															
<p>10. Pasqyra Mujore dhe mënyra e pagesës</p>	<p>Konsumatori duhet të paguajë: sipas pasqyrave mujore (nxjerrja e llogarisë së kartës së kreditit), në të cilën përfshihen të gjitha veprimet e kryera brenda ciklit të pasqyrës mujore të zgjedhur nga konsumatori në formularin e aplikimit për kartë krediti, si dhe interesat dhe komisionet respektive sipas kushteve të punës. Pagesa duhet të kryhet brenda ditës së fundit të pagesës. Ky është një produkt fleksibël përsa i përket pagesës. Shuma minimale për t'u paguar do të jetë 25% e shumës së faturuar. Konsumatori mund të zgjedhë të paguajë një shumë nga 25% deri në 100% të detyrimit/shumës për t'u paguar për periudhën. Për pagesën e shumës minimale (25%) ose shumës totale (100%), banka vë në dispozicion pagesën automatike në ditën e fundit të pagesës, sipas zgjedhjes së klientit në formularin e aplikimit. Nëse nuk disponon ose nuk krediton me gjendje të mjaftueshme llogarinë e lidhur me kartën ose dëshiron të paguajë me shumë sesa pagesa automatike e zgjedhur, konsumatori mund të paguajë edhe nga dega "internet", BKT Smart, ATM ose të paraqitet për të bërë pagesë në degë.</p> <p><u>Shembull:</u> Limiti total i kartës 100,000 LEK Shpenzime për periudhën 20,000 LEK Shuma totale për t'u paguar 20,000 LEK (100%) Shuma minimale për t'u paguar 5,000 LEK (25%) Konsumatori paguan 10,000 LEK ($5000 \leq 10,000 \leq 20,000$)</p> <p>Interesa dhe/ose komisionet do të paguhet në mënyrën e mëposhtme: - Komisioni vjetor i kartës përfshihet në pasqyrën mujore të 1-rë dhe përsëritet çdo vit në të njëjtën periudhë. Sipas ofertave në fuqi të BKT, karta e kreditit ofrohet pa komision për vitin e 1-rë dhe për vitet në vijim ky komisioni i kthehet konsumatorit në formën e bonusit për blerje mbi shumën e përcaktuar sipas ofertës. - Interesi për detyrimin e mbartur (sales interest - 2%) llogaritet nga data e pasqyrës mujore deri në datën e pagesës për shumën e paguar dhe nga data e pasqyrës mujore deri në datën e ardhshme të pasqyrës mujore për shumën e papaguar dhe përfshihet në pasqyrën e muajit pasardhës. Për pagesë të detyrimit total brenda ditës së fundit të pagesës, nuk përllogaritet interes.</p>															

	<p>- Komisioni për tërheqje nga ATM përfshihet në të njëjtën pasqyrë mujore me tërheqjen.</p> <p>- Interesi për tërheqje llogaritet nga data e tërheqjes deri në datën e pagesës dhe përfshihet në pasqyrat mujore respektive.</p>
11. Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar	<p>Nëse konsumatori paguan rregullisht detyrimin total sipas pasqyrave mujore atëherë: Totali i kostos së kredisë = shuma e totalit të kredisë + komisioni vjetor + komisionet & interesat e tërheqjeve (nëse ka të tilla) + komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë (nëse ka).</p> <p>Nëse konsumatori paguan detyrimin minimal ose shumë tjetër nën detyrimin total atëherë: Totali i kostos së kredisë = shuma e totalit të kredisë + komisioni vjetor + interesat për detyrimin e mbartur + komisionet & interesat e tërheqjeve (nëse ka të tilla) + komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë (nëse ka).</p>
12. Kosto të tjera të lidhura me kredinë	<p>Karta e kreditit duhet të lidhet me një llogari rrjedhëse të konsumatorit në BKT në monedhën LEK, nëpërmjet të cilës do të kryhen pagesat automatike të kartës. Kostot për mbajtjen e kësaj llogarie do të jenë sipas kushteve të punës në fuqi. Megjithatë për kategori të caktuara klientesh (si pagamarrës, kredimarrës, etj.) mbajtja e llogarisë në BKT trajtohet pa komision.</p> <p>Bazuar në rregullat ndërkombëtare, bankat e tjera mund të aplikojnë komisionet e tyre për transaksione të procesuara në терминаlet e tyre të pranimit të pagesave, si POS-et, ATM-të apo POS-et virtuale për pagesat në internet. Në të tilla raste, këto komisione mbahen nga karta por nuk i përkasin BKT-së.</p>
13. Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese	<p>Në çdo rast tejkalimi limiti si rezultat i blerjeve të kryera dhe interesave/komisioneve të përfshira në pasqyrën mujore, konsumatori do të ngarkohet me: Komision për tejkalim limiti i cili përfshihet në të njëjtën pasqyrë mujore.</p>
14. Kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë	<p>Nëse karta nuk do të merret nga konsumatori brenda një periudhe 1-mujore nga data e njoftimit, Banka ka të drejtën e anulimit të saj. Për pajisjen me një kartë të re, konsumatori duhet të paguajë komision për riprintimin e kartës + PIN-it.</p>
15. Kosto Sigurimi	Nuk aplikohet
16. Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale.	Nuk aplikohet
17. Kostot në rastin e pagesave me vonesë	<p>Në rast se nuk paguan të plotë dhe/ose në kohë detyrimin minimal, Konsumatori do të ngarkohet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisionin për pagesë të vonuar, i cili përfshihet në pasqyrën e muajit pasardhës. - Interesin për pagesë të vonuar (late payment interest - 5%), i cili llogaritet nga data e pasqyrës mujore deri në datën e pagesës/ pasqyrës mujore të ardhshme për detyrimin minimal të papaguar dhe përfshihet në pasqyrën e muajit pasardhës. <p>Duke qenë se dy interesa të ndryshëm nuk mund të aplikohen mbi të njëjtën shumë, shuma mbi të cilën llogaritet interesi për pagesë të vonuar (shuma minimale për t'u paguar) zbritet nga shuma për llogaritjen e interesit për detyrimin e mbartur.</p>
18. Shlyerja para afatit të maturimit	<p>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesëshme ose të plotë të kredisë.</p> <p>Konsumatori në çdo kohë mund të paguajë nga dega "internet", BKT Smart, ATM ose të paraqitet për të bërë pagesë në degë. Informacioni për transaksionet akoma të pafaturura, mund të merret në vend.</p>
19. Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Nuk aplikohet
20. Njoftimi zyrtar midis paleve	<p>Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomande) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë, ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail të përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD, Kuti Postare).</p> <p>Edhe në rast se limiti i aprovuar është i ndryshëm nga ai i kërkuar, dega e bankës në të cilën është bërë aplikimi do t'ia komunikojë këtë konsumatorit duke marrë konfirmimin e tij për lëshimin e kartës në limitin e aprovuar.</p> <p>Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara do të konsiderohen si të marra nga ai.</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këtë ndryshim. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.</p>
21. Njoftimi në rast refuzimi të kredisë	<p>Nëse konsumatori nuk përmbush ndonjë nga kriteret ose aplikimi refuzohet, dega e bankës në të cilën është bërë aplikimi do t'ia komunikojë atij arsyet e mos-kualifikimit për kartë krediti.</p>
22. Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së	<p>Edhe në rast se limiti i aprovuar është i ndryshëm nga ai i kërkuar, dega e bankës në të cilën është bërë aplikimi do t'ia komunikojë këtë konsumatorit duke marrë konfirmimin e tij për lëshimin e kartës në</p>

pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	limitin e aprovuar.
23. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë	Konsumatori ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata duke dhënë një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës. Në qoftë se Konsumatori tërhiqet nga kontrata pas marrjes dhe përdorimit të kartës, kontrata do të quhet e zgjidhur ditën që Kartëmbajtësi shlyen plotësisht detyrimet e kartës të njoftuara nga Banka.
24. Skemat e brendshme të ankimit	- Klientët kanë mundësi të depozitojnë një ankesë apo sugjerim përmes kanaleve të mëposhtëm: - Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë çdo dege. - Vizitë pranë çdo dege. - Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center - Nëpërmjet adresës elektronike: info@bkt.com.al - Nëpërmjet Aplikacionit BKT Smart - Nëpërmjet Postes Zyrtare - Nëpërmjet formës së dedikuar në faqen zyrtare të BKT-së - Nëpërmjet formularit të ankesave dhe sugjerimeve në Facebook
25. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti.

_____/_____/_____
(Qyteti, dd,mm,vvvv)

Klienti: Emër Mbiemër
(Firma)